



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE**

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, KONTROLLIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

KORÇË MË ___/___/2023

RELACION

**“PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË KORÇË TË KATIT PËRDHE TË OBJEKTIT ME EMËRTIM "ISH
SHTËPIA E USHTARAKËVE" KORÇË**

Bazuar në Vendimii Keshillit te Minisrave nr.201 datë 04.03.2015“*Për kalimin ne pergjegjesi administrimi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit te Ministria e mireqenies sociale dhe rinise, per qendren rinore korce, te katit te pare te objektit, me emertim isht shtepia e ushtarakeve Korçë*”kati përdhe i godinës së Ish Shtëpisë së Ushtarakëve i ka kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë me qëllim zhvillimin e veprimtarisë së Qendrës Rinore Korçë.

Bashkangjitur VKM-sësë sipërcituar janë planimetritë. Planimetria e antresolit dhe planimetria e katit përdhe. Antresoli ka një sipërfaqe prej 133 m2. Kati përdhe ka një sipërfaqe prej 225.928 m2.

Dy katet e tjera të kësaj godine janë në pronësi të Bashkisë Korçë, të regjistruara dhe për të cilat Bashkia Korçë disponon çertifikata pronësie, konkretisht pasuritë 7/984 + N4 ZK 8562 Vol.41 faqe 99 me sipërfaqe 327.5 m2 dhe 7/984 + N3 ZK 8562 Vol.41 Faqe 98 me sipërfaqe 327.5 m2.

Në kuadër të realizimit të funksioneve të Bashkisë në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve sociale, referuar neneve 24 dhe 25 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ambienti objekt i këtij relacioni kërkohet të transferohet në pronësi të Bashkisë Korçë për zhvillimin normal të veprimtarisë së funksionimit të Qendrës Rinore dhe investimeve që planifikohen të kryen në këtë objekt.

Pas verifikimeve të kryera në terren nga ana e specialistëve të Bashkisë Korçë sipërfaqja e përgjithshme për transferim në favor të Bashkisë Korçë është pasuri e llojit ndërtesë, pasuri nr. 7/984-N1ZK 8562, me sipërfaqe 133 m2 antresoli dhe 225.928 m2 kati përdhe.

Bazuar në sa u tha më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Korçë të autorizojë fillimin e procedurave nga ana e Bashkisë Korçë, për transferimin e pasurisë nr. 7/984-N1 ZK 8562, me

sipërfaqe 133m² antresoli dhe 225.928 m² kati përdhe me vendndodhje në godina e Ish Shtëpisë së Ushtarakeve, me adresë në Bulevardi Republika, Bashkia Korçë.

Si rrjedhojë, bazuar në nenin 9 pika 1.2 gërmat a) “njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e tyre të paluajtshme sipas mënyrës së përcaktuar në ligj” dhe c) “e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës” të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe bazuar në ligjin 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, njësi të qeverisjes vendore” dhe ligjit Nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Neni 40 “Ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit dhe transferimi” i propozojmë Këshillit Bashkiak Korçë të autorizojë fillimin e procedurave për transferimin në pronësi të Bashkisë Korçë, të pasurisë nr.7/984-N1 ZK 8562, me sipërfaqe 133 m² antresoli dhe 225.928 m² kati përdhe sipas planimetrive bashkangjitur këtij relacioni.

Bashkangjitur këtij relacioni:

- Planimetritë e katit përdhe të ndërtesës së Ish Shtëpisë së Ushtarakëve + planimetri e antresolit.

Drejtoreshë e Përgjithshme
Anxhela (Dishnica) Qeramixhi Zhaneta Lubonja

Drejtoreshë e DPKZHT

KRYETARI

Sotiraq FILO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË
P/VENDIM

Nr _____, datë ____/____/2023

“PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË TË KATIT PËRDHE TË OBJEKTIT ME EMËRTIM "ISH SHTËPIA E USHTARAKËVE" KORÇË

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe DPKZHT bazuar në nenin 9 pika 1.2 gërma a) të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe bazuar në ligjin nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, njësive të vetëqeverisjes vendore” dhe VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave organeve të qeverisjes vendore” dhe bazuar në Ligjin 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” neni 40;

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procedurave për transferimin në pronësi të Bashkisë Korçë tëpasurisë nr.7/984-N1ZK 8562, me sipërfaqe 133 m2 antresol dhe 225.928 m2 kati përdhe, sipas planimetrive bashkangjitur këtij relacioni, me vendndodhje në Ish Shtëpia e Ushtarakeve, Bulevardi Republika, Bashkia Korçë.
2. Qëllimi i transferimit është përdorimi i kësaj prone për zhvillimin e aktivitetit të Qendres Rinore Korçë.
3. Përzbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimittë Burimeve Njerzore dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimi të Territorit, Bashkia Korçë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇIKRYETARI

ANA VERUSHI

Miratuar me _____vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____